



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:032428

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05392688

PKR.nr.13/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti për Krime të Rënda, kryetarja e trupit gjykues Ajser Skenderi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Floridin Osmanaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit G.I., nga Shkupi i Republikës së Maqedonisë Veriore, me banim në rr” “, për shkak se ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP/I.18/2024 të datës 22.02.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datën 29.02.2024, në prezencën e prokurorit të shtetit Genc Nixha, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij avokat N.C., nga Prizreni, më datën 29.02.2024, morri, e shpalli dhe e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

G.I., nga i ati dhe e ëma– e vajzërisë, i lindur mënë Shkup, ku edhe jeton në Rr. ‘....., punëtor, e ka të kryer shkollën e mesme të lartë, punëtor në internet kafe, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë Veriore, me numër personal:, i cili gjendet në ndalim nga data 28.01.2024 prej orës 05:00.

ËSHTË FAJTOR

Se më datë 28.01.2024, në ora 02:30, në Pikën e kalimit kufitar të Vërmicës, pa autorizim blen ose posedon – me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, në atë mënyrë që pasi policia kufitare kishte ndaluar automjetin e markës ‘.....” me targa të rregjistrimit ‘....., të cilin ishte duke e drejtuar dëshmitari M.T., , brenda të cilit automjet, në ulësen e pasagjerit ishte i pandehuri në fjalë, me ç’rast gjatë kontrollit fizik të të njejt, nën rrobat e tij policia ka gjetur një qese plastike me substancë narkotike të llojit marihuanë, në peshë të përgjithshme prej 28.07 gram (njëzet e tetë gram e 07 miligram), të cilën substancë e kishte blerë në Republikën e Shqipërisë.

-Këso dore ka kryer veprën penal blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko-trope dhe analoge nga neni 267, par.1 të KPRK.

Andaj gjykata, konform dispozitave të nenit 7, 17, 38, 42, 43, 44, 69, 70, 71, 72, 79 në lidhje me nenin 267 par.1 të KPRK e :

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumën **prej 600 euro** dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve, në të cilin dënim me burgim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 28.01.2024 gjer në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

Obligohet i akuzuari që dënimin me gjobë konform nenit 43 paragrafi 2 të KP ta paguajë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konform nenit 43 paragrafi 3 të KP nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën dënimin me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që 20 euro gjobë do të llogaritet barabartë me një ditë burgim.

Konform nenit 44 të KP, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve i zëvendësohet me dënim me gjobë ashtu që të njëjtit i shqiptohet dënimin me gjobë në shumën **prej 1.500 euro**.

Konform nenit 267 par. 5 të KPP,nga i akuzuari G.I., konfiskohet substanca narkotike e llojit “kanabis” në peshë të përgjithshme prej 28.07 gram.

Obligohet i akuzuari G.I., që në emër të shpenzimeve gjyqësore – paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej nga 50 euro si dhe të paguaj shumën prej 50 euro për programin për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ndaj të akuzuarit G.I., nga Shkupi i Republikës së Maqedonisë Veriore, ka ngritur aktakuzë nën numrin PP/I.nr.18/2024 të datës 22.02.2024 për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së,si dhe në gjykatë ka parashtruar edhe marrëveshjen e arritur mbi pranimin e fajësisë.

Në lidhje me këtë çështje, gjykata e ka caktuar shqyrtimin fillestar më datë 29.02.2024, në të cilin shqyrtim i akuzuari G.I., e ka pranuar fajësinë për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1. të KPRK duke cekur se me Prokurorinë e Shtetit në prezencën e avokatit mbrojtës më datën 22.02.2024 ka lidhur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, paraprakisht nga ana e Prokurorit dhe avokatit mbrojtës i është shpjeguar natyra dhe pasojat e pranimin të fajësisë, marrëveshjen për pranimin e fajësisë e ka lidhur me vullnetin e lirë pa kurrëfarë presioni, kërcënimi dhe se është pajtuar në

tërësi me dënimin e rekomanduar nga ana e Prokurorit të Shtetit, andaj edhe ka propozuar që marrëveshja mbi pranimin e fajësisë të aprovohet në tërësi.

Prokurori i Shtetit poashtu ka propozuar që marrëveshja e arritur të aprovohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. N.C., ka theksuar se qëndron pranë marrëveshjes së arritur mbi pranimin e fajësisë dhe i propozoi gjykatës që gjykata të njëjtën marrëveshje të aprovon ndërsa sa i përket dënimin të propozuar në marrëveshje mbetet në diskrecion të gjykatës shqiptimi i dënimin. Po ashtu thekson se dënimi të cilin ia shqipton gjykata në të holla do të kryhet nga mbrojtësi, pasi që të hollat janë të siguruar nga familjarët e të akuzuarit.

Në shqyrtimin fillestar të datës 29.02.2024 pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale blerja, posedimi shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotike, supstancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1. të KP, gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë dhe marrëveshjen e arritur mbi pranimin e fajësisë, i cili pranim është bërë konform neni 230 par.17 në lidhje me nenin 242 të KPRK-së, i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimeve me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 par.1. të KPP, andaj gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve supstancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1. të KP, pasi që më datë 28.01.2024, në ora 02:30, në Pikën e kalimit kufitar të Vërmicës, pa autorizim blen ose posedon – me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, në atë mënyrë që pasi policia kufitare kishte ndaluar automjetin e markës ‘.....me targa të regjistrit ‘....., të cilin ishte duke e drejtuar dëshmitari M.T., , brenda të cilit automjet, në ulësen e pasagjerit ishte i pandehuri në fjalë, me ç’rast gjatë kontrollit fizik të të njëjtit, nën rrobat e tij policia ka gjetur një qese plastike me substancë narkotike të llojit marihuanë, në peshë të përgjithshme prej 28.07 gram (njëzet e tetë gram e 07 miligram), të cilën substancë e kishte blerë në Republikën e Shqipërisë për çka edhe gjykata e shpalli fajtor dhe ia shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që vërtetoi se është penalo juridikisht përgjegjës.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konform neni 69 dhe 70 të KPRK-së, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimin, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimin, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimin, shkallën e përgjegjësisë dhe motivet nga të cilat është kryer vepra penale dhe si rrethanë lehtësuese morri parasysh pranimin e fajësisë-marrëveshjen e arritur mbi pranimin e fajësisë me Prokurorinë dhe se është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, pasi që gjykata nuk ka prova-ndonjë aktgjykim të plotëfuqishëm se i njëjti është dënuar edhe më herët për ndonjë vepër penale, Ndërsa si rrethana rënduese gjykata morri parasysh llojin dhe sasinë e narkotikut të gjetur ku kemi të bëjmë fjalë për substancë të llojit marihuanë, bimë narkotike të cilat sipas Ligjit për barënat narkotike, supstancat psikotrope dhe analoge, renditen në tabelën e I-rë, bimët, barënat narkotike dhe supstancat psikotrope me rrezikshmëri të lartë, veprimtaria e të cilave është e ndaluar në Kosovë, faktin se përdorues të këtyre supstancave janë kryesisht të rinjtë e që ndikon negativisht në zhvillimin e tyre psiko fizik dhe se veprën penale e ka kryer me qëllim të përfitimit material, mënyrën e kryerjes së veprës penale e cila substancë ishte blerë në Republikën e Shqipërisë, sasia e narkotikut ka qenë e fshehur nën rrobat e tij me qëllim të shitjes, faktin se i akuzuari veprën penale e ka kryer për përfitime personale, andaj është mendimi i gjykatës se dënimi i këfillë i shqiptuar si në dispozitiv është në harmoni me

intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, dhe se do të mundësoj një balancë të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarit, t'i mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit. Gjykata vendosi për këtë lloj të dënimit pasi që krijoi bindjen se i akuzuari në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tjera penale dhe se është mendimi i gjykatës se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe që të përmbahet, nga veprimet e tilla apo të ngjashme.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve është marrë në kuptim të nenit 267 paragrafi 5 të KPRK-së në lidhje me nenin 269 dhe 270 të KPPK.

Vendimi i gjykatës për llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar me burgim, është marrë në përputhje me nenin 79 paragrafi 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 paragrafi 2 pika 2.6. lidhur me nenin 450 paragrafi 1 të KPPK-së.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimit e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 36 par.3 nën par.3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.8/L-109.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,
2024:032428, 29.02.2024**

B. Profesional

Floridin Osmanaj

Kryetarja e trupit gjyqësor

Ajser Skenderi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykata.